

**STATUT DHE AKT THEMELIMI  
PER KRIJIMIN SI PERSON JURIDIK TE SHOQERISE  
“E.R One Albania” SH.P.K.**

Sot me date 25 / 04 / 2016 ky Statut u perpilua nga ortaket themelues ne prani te perkthyeses ligjore Anila Berberi me nr. licence :

1. Stela Gugallja e bija e Feridid, lindur ne Tirane me date 18/01/1980, banuese Rr Sheh Ahmet Pazari, P/Ambasador, Tirane, i pajisur me Nr. Karte ID 026766202 madhore e me zotesi te plote juridike per te vepruar.
2. Energy Recuperator S.P.A me seli ligjore ne Carpenedolo Brescia, Via Colombo 27 CAP 25013, Kod fiskal 02074150174 dhe Nipt. 00681670980, perfaqesuar nga presidenti i keshillit administrativ Ernesto Granelli, me shtetesi Italiane, lindur ne Carpenedolo me 08/12/1944 dhe banues ne Carpenedolo(BS), Via Cesare Abba 120, me nr. Karte ID AT2562708.

Te quajtur me poshte ortaket themelues, te cilet ne perputhje me ligjin nr.9901, date 14.04.2008 “Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare”, krijojne nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar si vijon:

**KREU I**

**NENI 1  
FORMA**

Ortaket e mesiperm krijojne nje Shoqeri me Pergjegjesi te kufizuar ne perputhje me legjislacionin ne fuqi ne Shqiperi dhe me dispozitat e ketij Statuti.

**NENI 2  
EMRI I SHOQERISE**

**Emri i shoqerise do te jete “E.R One Albania” SH.P.K.**

**NENI 3  
SELIA E SHOQERISE**

Selia qendrore e shoqerise do te jete ne qytetin e Tiranës me adrese Rr."5 Maj", Kompleksi Concord Center, Kulla III, Shkalla II, Ambjenti 29, Kati 5. Shoqeria ka te drejte qe me vendim te ortakeve te shoqerise mund te hape dege, zyra, filiale ose perfaqesi te shoqerise ne qytete te tjera te Shqiperise ose jashte vendit.



## **NENI 4 KOHEZGJATJA**

Shoqeria do te kete kohezgjatje te papercaktuar. Si date fillestare merret data e regjistrimit te saj ne Qendren Kombetare te Regjistrimit.

## **NENI 5 OBJEKTI I VEPRIMTARISE**

Import eksport te materialeve te ndryshem qe kane lidhje me objektin e veprimtarise. Import eksport e tregtim me shumice dhe pakice te mallrave te ndryshem industriale te perdorimit te gjere, telekomunikacion, aktivite komisionimi, tregti te pergjithshme, sherbime konsulence, instalime dhe ngritje terminalesh, ndertime dhe punime civile te ndryshme. Ndertim Hidrocentrale dhe Termocentrale te kapaciteteve te ndryshme. Prodhim, montim dhe tregti me shumice dhe pakice i paneleve per prodhimin e energjise diellore, dhe aksesoreve te tyre brenda dhe jashte territorit te Republikes se Shqiperise. Trajtim i mbetjeve te ndryshme, organike dhe te ngurta. Instalimi i linjave dhe kabinave elektrike te Tensionit te Ulet. Zhvillimin e veprimtarise minerare me punime siperfaqesore dhe nentokesore. Transport e pune me lende plasese. Perpunim, trajtim, menaxhim dhe transport te mbetjeve.

Ndertimi, instalimi, shitja dhe prezantimi I produkteve dhe impianteve elektrike dhe elektronike apo te sistemeve lidhese te integruar apo perberes. Ndertimi instalimi, mirembajtja, dhe asistenca e impianteve industriale dhe civile te kondicionimit ngrohjes per prodhimin dhe kursimin e energjise. Tregtimi brenda dhe jashte vendit i te gjitha produkteve, makinerive dhe pajisjeve te tjera te kesaj fushe. Prodhimi i energjise ne te gjitha format e saj. Distribuimi, tregtimi i transportimi i energjise, transportuesve te energjise te te gjitha natyrave

## **KREU II KAPITALI THEMELTAR , KONTRIBUTET, PJESET E KAPITALIT THEMELTAR DHE TRANSFERIMI**

### **NENI 6**

Kapitali themeltar i shoqerise eshte 100.000 (njqind mije) leke, i ndare ne 2 kuota.

### **NENI 7 KONTRIBUTET**

1. Ortaku themelues Stela Gugallja zoteron nje kuote me perqindje 40% dhe vlere te pergjithshme 40 000 leke.
2. Ortaku themelues Energy Recuperator S.P.A zoteron nje kuote me perqindje 60% dhe vlere te pergjithshme 60 000 leke.



Kontributi i ortakëve mund të jetë në para dhe në natyrë (pasuri të luajshmë apo të paluajshmë dhe të drejta të vlerësueshme në para).

#### **NENI 8**

Fitimi i realizuar nga aktiviteti i shoqërisë i takon ortakëve themelues në masën 100%.

#### **NENI 9**

#### **TRANSFERIMI I PJESEVE TE KAPITALIT THEMELTAR**

Kuotat e kapitalit të shoqërisë mund të transferohen me anë aktesh mes të gjalleve dhe me trashëgimi. Transferimi i kuotave të kapitalit të shoqërisë nuk i nënshtrohet asnjë lloji kufizimi, në qoftë se ndodh në rast vdekjeje.

#### **KREU III**

#### **MARRJA E VENDIMEVE, ADMINISTRIMI DHE KONTROLLI I SHOQËRISE NENI 10**

#### **ASAMBLEJA E ORTAKEVE**

Asambleja e ortakëve organizon, drejton dhe kontrollon gjithë aktivitetin e shoqërisë. Ortaku përballon humbjet e shoqërisë deri në kufirin e vlerës së kontributit të tij.

#### **NENI 11**

#### **DREJTIMI I SHOQËRISE**

Organi më i lartë drejtues i shoqërisë do të jetë asambleja e ortakëve. Asambleja e ortakëve mbledhet si rregull dy herë në vit, si dhe sa herë që gjykohet e arsyeshme.

#### **NENI 12**

#### **KOMPETENCAT E ASAMBLESE SE ORTAKEVE**

1. Asambleja e përgjithshme është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:
  - a. përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
  - b. ndryshimet e statutit;
  - c. emërimin e shkarkimin e administratorëve;
  - ç) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
  - d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "ç" të kësaj pike;

- dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
  - e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
  - ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
  - f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
  - g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
  - gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
  - h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- d. çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.
2. Asambleja e përgjithshme merr vendime për çështjet e përcaktuara në shkronjat "e" dhe "ë" të pikes 1 të këtij neni, pas marrjes dhe shqyrtimit të dokumenteve përkatës.
  3. Asambleja e ortakeve vendos për çdo çështje që ajo gjykon të arsyeshme.

### NENI 13 ADMINISTRATORI

Shoqëria do të administrohet nga administratori **Z. Mirel Mertiri** i biri i Trifonit, lindur në Fier, me datë 08/08/1978, banues Rr "Sheh Ahmet Pazari", P/Ambasador, Tirane, i pajisur me kartë ID me nr.030602167 madhor e me zotësi të plote juridike për të vepruar.

### NENI 14 KOMPETENCAT E ADMINISTRATORIT

Administratori i shoqërisë emerohet nga asambleja e ortakeve, i cili përgjigjet për zbatimin e vendimeve të asamblese së ortakeve. Afati i emerimit në detyrë të administratorit do të jetë 5 vjet. Administratori ka këto kompetenca :

- a) Te kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikën tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
- b) Te përpilojë dhe nënshkruajë kontratat dhe aktet juridike që kanë të bëjnë me veprimtarinë e shoqërisë.
- c) Te hapë llogari rrjedhese bankare pranë bankave shqiptare ose të huaja.
- d) Te përfaqësojë shoqërinë në marrëdhënie me të tretet.
- e) Te emerojnë nëpunës të rangjeve të ndryshme për veprime të veçanta teknike ose për një kategori të caktuar veprimesh.
- f) Te përfaqësojnë shoqërinë tregtare;
- g) Te kujdesen për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- h) Te përgatisin dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
- i) Te krijojnë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- j) Te kryejnë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;



- k) Te raportojnë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
- l) Te beje gjithçka tjetër që konsideron të dobishme dhe që është në përputhje me formën e këtij Statuti e të Aktit Themelues si dhe me legjislacionin shqiptar në fuqi, për të arritur qëllimin dhe objektin e shoqërisë.

## **KREU V**

### **LIBRAT E LLOGARISE, BILANCI, FITIMI, SHPERNDARJA DHE LIKUJDIMI**

#### **NENI 15**

Shoqëria është e detyruar të mbajë përveç dokumentacionit kontabel që kërkon legjislacioni në fuqi edhe keto libra :

- 1- Libri i ortakëve, në të cilin shënohen emrat e plote të Ortakëve dhe kuotat që secili ka në kapitalin e themelimit.
- 2- Libri i mbledhjeve dhe i vendimeve të asamblese.
- 3- Libri i mbledhjeve dhe i vendimeve të Administratorit
- 4- Libri i mbledhjeve dhe i vendimeve të organit sindikal.

#### **NENI 16**

### **VITI FINANCIAR, LLOGARITE VJETORE, EKSPERTI KONTABEL**

Çdo vit financiar fillon me 1 Janar dhe mbaron me 31 Dhjetor. Përjashtimisht viti i parë financiar mund të fillojë pas regjistrimit të shoqërisë si person juridik dhe do të përfundojë me 31 Dhjetor 2016. Llogarite vjetore, inventaret, raportet mbi operacionet e veçanta të hartuara nga administratori miratohen nga asambleja e ortakëve. Miratimi i dokumenteve mbi veprimtarinë vjetore bëhet brenda një afati prej 6 muajsh nga data e mbylljes së vitit financiar.

#### **NENI 17**

### **AKTIVITETI FINANCIAR**

Në çdo mbyllje çdo viti financiar administratori bën inventarin dhe llogarinë vjetore në përputhje me dispozitat e legjislacionit në fuqi për kontabilitetin, si dhe hartohet një raport me shkrim Bilancit i bashkëngjiten:

- a. Një situacion mbi garancitë e dhëna nga shoqëria,
- b. Një situacion mbi sigurimet e bera nga shoqëria,

Raporti i administratorëve përfshijë gjendjen gjatë vitit financiar të kaluar, ndryshimet e parashikuara, veprimtaritë e mundshme që janë zhvilluar nga data e mbylljes së vitit financiar deri në ditën që është hartuar ky raport.



Dokumentet vihen ne dispozicion te eksperteve kontabel te autorizuar, te pakten nje muaj para mbledhjes se asamblese.

#### **NENI 18**

Fitime neto te shoqerise do te konsiderohen fitimet qe rezultojne pas zbritjes nga te ardhurat e te gjitha shpenzimeve qe kane lidhje me aktivitetin e shoqerise, detyrimet fiskale, shoqerore, demet, amortizimet, etj ne perputhje me legjislacionin shqiptar.

Shoqeria krijon fondin rezerve dhe fonde te tjera te veçanta financimi.

Perberja, shumata e pergjithshme, burimet per krijimin e fondit rezerve, perdorimi dhe rregullmi i çdo fondi te veçante caktohet nga ortaku i vetem ne perputhje me legjislacionin shqiptar.

Ne perputhje me ligjin nga fitimi i rezervuar gjate vitit financiar lihet menjane nje shume me vlere 1/20 e cila destinohet per krijimin e nje fondi "rezerve e domosdoshme".

#### **NENI 19**

#### **PRISHJA E SHOQERISE**

Shoqeria priset me kalimin e afatit te caktuar ne statut dhe per arsye te parashikuara ne ligj. Shoqeria priset perpara afatit me vendim te Asamblese ortakeve.

#### **NENI 20**

Rastet e pavlefshmerise se shoqerise ose te nje akti qe ndryshon statutin si dhe bashkimi dhe ndarja e shoqerise behet ne perputhje me dispozitat e ligjit.

#### **NENI 21**

Kur shoqeria priset ajo kalon ne likujdim dhe ne kete rast emertimit te shoqerise i shtohet shenimi "Shoqeri ne likujdim e siper". Shoqeria edhe gjate procesit te likujdimit vazhdon si person juridik deri ne perfundimin e procesit te likujdimit. Prishja e shoqerise eshte me pasoje ndaj te treteve vetem pas publikimit te prishjes ne regjistrin tregtar.

#### **NENI 22**

Per te perfunduar procesin e likuidimit, Asambleja e ortakeve emeron nje ose disa persona si likuidues te cilet perfaqesojne shoqerise. Likuiduesi perpilon bilancin financiar likujdon tek te tretet detyrimet e shoqerise, shet aktivet e shoqerise dhe ndan tepricat ne dispozicion.

#### **NENI 23**

Ne perfundim te mbylljes se likujdimit, ortaket thirren qe te vendosin per bilancin financiar perfundimtar per aktin e rregullshmerise, per admimstrimin e tij nga ana e likujduesit dhe per

heqjen e mandatit te likuiduesit, si dhe per t'u evidencuar mbyllja e likuidimit. Dokumentat e mesiperme miratohen nga Asambleja e ortakeve .

#### NENI 24

Kur shoqeria likujdohet pasurite qe jane vene ne dispozicion te shoqerise me te drejte shfrytezimi, u kthehen pronareve.

Mjetet financiare te fituara si rezultat i veprimtarise se shoqerise dhe fondet fillestare ndahen ndermjet ortakeve ne perpjestim me kuotat e vena pasi te jene likujduar kreditoret.

#### NENI 25

#### DISPOZITA TE FUNDIT

Shoqeria ka te drejte te punesoje punonjes qe i nevojiten per te ushtruar veprimtarine e saj. Punesimi behet sipas kushteve te percaktuara ne legjislacionin e punes se Republikes se Shqiperise, si dhe rregullave te vena ne kontraten e vecante te punesimit qe lidhet midis punedhenesit e punonjesit.

Te gjitha problemet qe do te lindin gjate ushtrimit te veprimtarise private te kesaj shoqerie do te zgjidhen sipas rregullave te percaktuara ne statutin dhe legjislacionin ne fuqi ne Republiken e Shqiperise.

Kur mosmarreshjet nuk zgjidhen ne mirekuptim kompetente per zgjidhjen e tyre eshte Gjykata e shkalles se pare Tirane.

#### NENI 26

Ky statut firmoset me vullnetin e lire te ortakut themelues.

#### ORTAKET THEMELUES

Stela Gugallja

*Stela Gugallja* 

Perkthyes

*Perkthyes*

*[Signature]*

Energy Recuperator S.P.A

*Enxheli Enxheli*

ENERGY RECUPERATOR S.P.A.  
Via Colombo, 27 - 25013 CARPENEDOLO (BS)  
Tel. 030 9698488-9697555-9669880 Fax 969397  
Cap. Soc. € 430.573 i.v. - R.E.A. BS 297248  
C.F. 02074150174 - P.IVA 00681670980

BERBERI  
TRADUTTORE GIURATO  
ACCREDITATO PRESSO IL  
MINISTERO DELLA GIUSTIZIA  
RIKAVANT NR. 116, TEK SELJA WOLKSVAGEN  
Tel. +355 682058937